



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2019:247142

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05829881

Ac.nr.10781/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët N. Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve N.S., E.S., E.S1, E.S2., F.S., F.H.dhe E.K.që të gjithë nga Fsh....., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Feride Ceka Marevci, avokate nga Prishtina kundër të paditurave; 1.Kompania e Sigurimeve "Siguria" në Prishtinë të cilën e përfaqëson me autorizim Av. Labinot Buzuku nga Hajvalia dhe e paditura e dytë 2.Byroja Kosova e Sigurimeve me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson Diellza Hajdari juriste në BKS, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditësve, ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës së parë dhe përgjigjes në ankesës së përfaqësueses së autorizuar të paditurës së dytë, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1268/18, i datës 27.07.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 11.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN të pabazuara ankesa e të autorizuarës të paditësve: N.S., E.S., E.S1, E.S2., F.S., F.H.dhe E.K.që të gjithë nga Fsh....., dhe ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës së parë: Kompania e Sigurimeve "Siguria" me seli në Prishtinë ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1268/18, i datës 27.07.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1268/18, i datës 27.07.2021, ka vendosur që të:

“I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e precizuar e paditësve, DETYROHEN të paditurat 1.Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" në Prishtinë dhe 2.Byroja Kosova e Sigurimeve me seli në Prishtinë që paditësve për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes B.S.në aksidentin e komunikacionit me datën 18.12.2017, t’ia kompensoj dëmin jo material dhe demin material si në vijim:

a).Në emër të dëmit jo material:

-Padiësve N.S., E.S., E.S1, E.S2., F.S., F.H.dhe E.K.të kompensohet shuma 5,400.00€ për secilin veç e veç, gjithsejtë 37,800.00€, në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e të afërmit të tyre-prindit B.S.

Shuma e përgjithshme për të gjithë padiësit në emër të dhimbjeve shpirtërore në lartësi prej 37,800.00€.

b). Në emër të dëmit material:

-Për ngritjen e përmendores dhe shpenzimet e varrimit shumën prej 1000.00 € dhe atë e paditura e parë 600€ apo llogaritur në përqindje 60% të shumës së gjykuar, ndërsa e paditura e dytë shumën 300€ apo 30% të shumës së gjykuar.

Gjithsej për të gjithë padiësit për dëmin jo-material në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të vdekjes së anëtarit të familjes, dëmin material, shpenzimeve të varrimit dhe ngritjes së përmendores, shumën prej 38,800.00€.

II. DETYROHEN të paditurat, të paguajnë shumat e gjykuara, padiësit si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 38,800.00€ (tridhjetë e tetëmijë e tetëqind euro) dhe atë:

1).E paditura e parë Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë, obligohet që për secilin padiës të paguaj shumë prej 3,600.00 (tremijë e gjashtëqind euro), që në total arrin shumën 25,200.00€, apo shprehur në përqindje 60%, të shumës së gjykuar, dhe

2).E paditura e dytë Byroja Kosova e Sigurimeve me seli në Prishtinë, obligohet që për secilin padiës të paguaj shumë prej 1800.00€ (njëmijë e tetëqind euro), që në total arrin shumën 12,600.00€ (dymbëdhjetëmijë e gjashtëqind euro) apo shprehur në përqindje 30%, të shumës së gjykuar.

Obligohen të paditurat që për demin jo material dhe material të paguaj shumën e gjykuar në lartësinë prej 38,800.00€ (tridhjetë e tetëmijë e tetëqind euro), më kamatëvonesë në lartësi 8%, e cila do të llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe ti paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore, në shumën prej 6,900.00 euro (Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" me seli në Prishtinë shumën 4,830.00€ apo 70% të shumës së përgjithshme të shpenzimeve si dhe Byroja Kosova e Sigurimeve me seli në Prishtinë 2,070.00€ apo 30% të shumës), në afat prej 15 ditësh, pas marrjes – plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e padiësve mbi shumën e gjykuar edhe atë: për dëmin jo material, në emër të dhimbjeve shpirtërore për padiësit N.S., E.S., E.S1, E.S2., F.S., F.H.dhe E.K., gjithashtu gjykata refuzoi kërkesën për shpenzimet e varrimit si dhe ngritjen e lapidarit mbi shumën e gjykuar.”

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e autorizuar e padiësve në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës së parë si e bazuar, të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës së parë në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën në këtë aktgjykim dhe ta ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që

ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka pasur nga ana e të paditurës së dytë, dhe atë me propozim që të refuzohet aktgjykimi i atakuar dhe të hudhet poshtë padia, apo të prishet aktgjykimi dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të gjykohen shuma më të ulëta se me aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të paditësve, ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës së parë dhe ankesa e përfaqësueses së autorizuar të paditurës së dytë janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit në padinë e dt.23.04.2018 si dhe në seancat e mbajtura, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar kanë theksuar se me datën 18.12.2017 në lokacionin "Rr....." në H.....ka ndodhur aksidenti trafiku me fatalitet, ku i afërmi i paditësve- prindi B.S, në cilësi të këmbësorit nga goditja e automjetit me targa 01.....me drejtues Ç.G.ka pësuar lëndime të rënda trupore vdekjeprurëse nga të cilat ka ndërruar jetë në vendin e ngjarjes. Meqenëse me rastin e këtij aksidenti është shkaktuar vdekja e anëtarit të ngushtë të familjes, paditësit kërkojnë kompensimin e dëmit në emër të dëmit jo material dhe material në bazë të parashtrësës së precizuar me shkrim të dorëzuar në gjykatë me dt.28.09.2020. E autorizuara e paditësve gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadsisë edhe atë:

Për dhimbje shpirtërore për humbjen e të ndjerit B.S, paditësit : N.S., E.S., E.S1, E.S2., F.S., F.H.dhe E.K., kanë kërkuar shumën prej 15,000 €, për secilin veç e veç gjithsej, për të gjithë shumën prej 105.000,00 €. Për të gjithë paditësit në emër të dëmit jo material (dhimbje shpirtërore) shumën prej 105.000,00€ duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 3.5% nga dita e parashtrimit të padisë me dt.23.04.2018 e deri në pagesën definitive. Në emër të dëmit material, për shpenzime të varrimit shumën prej 1.500,00 € dhe ngritje të përmendores ka kërkuar shumën prej 1.000,00€ gjithsej shumën prej 2,500€.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, sipas parashtrësës së precizuar edhe atë për përpilimin e padisë 624.00€, për përfaqësime në 6 seanca nga 811.00 € gjithsej shumën 4,866.00€, për dy seanca të shtyra nga 405.00€ gjithsej shumën 410.00€, për parashtrësën për precizimin e kërkesëpadsisë shumën prej 624.00 €, për ekspertizën psikiatrike shumën 300.00€, për super ekspertizë të komunikacionit shumën 300.00€, për taksë gjyqësore për padi shumën prej 186.00€, gjithsej shpenzime procedurale në shumën prej 7,310.00€.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1268/18, i datës 27.07.2021, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në bazë të dëshmisë se vdekjes dhe certifikatave të lindjes për paditësit nuk është kontestuese legjitimiteti aktiv i palëve paditëse dhe legjitimiteti pasiv i të paditurave në këtë çështje juridiko civile, pasi që është vërtetuar se paditësit janë në lidhje të ngushtë familjare me të ndjerin B.S.dhe se i njëjti ka qenë babai i tyre. Nga raporti i aksidentit nr. 2017-AR-3360 i datës 18.12.2017 është vërtetuar se më këtë datë ka ndodhur aksidenti i përshkruar si më lartë si dhe automjeti 01.....me drejtues Ç.G.në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i siguruar te e paditura e parë. Nga konstatimi i ekspertit komunikacionit rrugor A.M.dt.11.02.2018 i caktuar

nga Prokuroria Themelore në Prishtinë është konstatuar se drejtuesi i automjetit A “Renault Kango” si pasojë e distancës së shkurtë që kishte mundohet ti shmangët aksidentit në anën e majtë por e prek me anën e djathtë këmbësorin dhe të njëjtin e rrëzon në rrugë ndërkaq pasi kalon automjeti A ndalet jashtë rruge në anën e djathtë, në atë moment vjen në të njëjtin drejtim automjeti B (NN) i cili si pasojë e pakujdesisë fare se vëren këmbësorin e shtrirë në rrugë, hip mbi këmbësor dhe e tërheq zvarrë duke mos u ndalur fare. Nga konstatimi i ekspertit të komunikacionit S.B.dt.26.10.2020 i caktuar nga Gjykata është konstatuar se aksidenti është shkaktuar nga lëshimet e ngasësit A për shkak se nuk e ka përshtatur shpejtësinë sipas shenjave, rregullave, kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion, pakujdesi e ngasësit A dhe jo vigjilenca e duhur gjatë lëvizjes në rrugë ku gjenden edhe këmbësorit, si dhe nuk i ka dhënë ndihmën e parë këmbësorit, ndërkaq që lëshimet e ngasësit B janë : Pakujdesia e ngasësit B dhe jo vigjilenca e duhur gjatë lëvizjes në rrugë ku gjenden edhe këmbësorët, nuk i ka dhënë ndihmën e parë këmbësorit(ka ikur nga vendi i ngjarjes), kurse lëshimet e këmbësorit B janë: pakujdesia gjatë kalimit të rrugës-jashtë vendkalimit për këmbësor, në rrugën e pandriçuar dhe me frekuentim të madh të automjeteve. Nga super ekspertiza mbi aksidentin e dt. 18.12.2017 e punuar nga grupi i ekspertëve T.B., J.B., F.S. e dt. 20.04.2021, është konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimit primar të drejtuesit të automjetit “A-Renault Kango” dhe lëshimit sekondar të drejtuesit të automjetit “NN”. Lëshimi i drejtuesit të automjetit transportues “A-Renault Kango” ka qenë primar sepse në pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti ka qenë i pakujdesshëm duke mos e vërejtur me kohë daljen e këmbësorit në rrugë dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, ndërsa lëshimet e drejtuesit të automjetit transportues “NN” ka qenë sekondar sepse në pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti ka qenë i pakujdesshëm duke mos vërejtur këmbësorin e shtrirë në rrugë dhe duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ndaj kushteve ekzistuese në rrugë duke shkelur dhe tërhequr zvarrë këmbësorin në rrugë. Nga mendimi i ekspertes së psikiatrisë Dr.N.M.i dt.16.06.2020 është konstatuar se me rastin e humbjes së anëtarit të ngushtë të familjes në aksidentin e dt.18.12.2017 pas ekzaminimit të drejtpërdrejt në lidhje me dhimbjet shpirtërore të familjarëve është dhënë mendim i veçantë për secilin paditës ku ekspertja e psikiatrisë ka konstatuar se: Paditësit N.S., E.S2., E.S1, E.S. dhe F.S.kanë përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që kanë zgjatur për 2 muaj, dhimbje të intensitetit të mesëm për 3 muaj dhe dhimbje të intensitetit të ulët e cila është prezentë edhe sot e kësaj dite. Paditësja F.S. dhe E.K. kanë përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që kanë zgjatur për 1 muaj, dhimbje të intensitetit të mesëm për 2 muaj dhe dhimbje të intensitetit të ulët e cila është prezentë edhe sot e kësaj dite.

Pas analizës së kësaj gjendje faktike të vërtetuar e duke ia falur besimin super ekspertizës së komunikacionit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur të bëjë ndarjen e përgjegjësisë për vëllimin e kontributit të pasojës së shkaktuar nga pjesëmarrësit në aksident në mes të drejtuesit të automjetit “Renault Kango” në shkallën 60 % i cili ishte i siguarur te e paditura e parë, dhe automjetit B (NN) në shkallën 30%, kurse këmbësori-tani i ndjeri ka kontribuar në këtë aksident 10% sepse i njëjti ka tentuar të kaloj rrugën në pjesën e rrugës ku nuk kishte vendkalim për këmbësor, kjo ngase në bazë të kësaj ekspertizave dhe super ekspertizës konstatohet se aksidenti ka ndodhur si pasojë e lëshimeve primare të drejtuesit të automjetit A “Renault Kango” sepse në pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti ka qenë i pakujdesshëm duke mos e vërejtur me kohë daljen e këmbësorit në rrugë dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ndaj kushteve ekzistuese në rrugë dhe nuk ka arritur të shmangët aksidentin me këmbësorin duke e goditur atë si dhe me lëshime sekondare të drejtuesit të automjetit “NN”, kjo ngase i njëjti në pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti ka qenë i pakujdesshëm duke mos e vërejtur këmbësorin e shtrirë në rrugë dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ndaj kushteve ekzistuese në rrugë kështu që nuk ka arritur të shmangët aksidentin me këmbësorin duke e shkelur dhe tërhequr zvarrë në rrugë. Andaj gjykata e

shkallës së parë duke vlerësuar këtë super ekspertizë në tërësi si të besueshme për mendimin profesional, si dhe duke u bazuar në nenin 176 të LIGJI NR. 04/L-077, i cili ishte në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit, vendosi që kërkesëpadia e paditësve të vlerësohet sipas ndarjes së përgjegjësisë së pjesëmarrësve në aksidentin e shkakuar ku me par. 1 dhe 2 të këtij neni përcaktohet: *“I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh nga sa do të ishte zakonisht, ka të drejtë vetëm për kompensim përpjesëtimisht të pakësuar”*. *“Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i dëmtuesit, gjykata do të gjykojë kompensimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit”*. Me rastin e vendosjes në lidhje me lartësinë e mbulimit të dëmit, për rastin e sigurimit të shkakuar është zbatuar Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë, numër 2001/25 i nxjerr nga Autoritetit Qendror Bankar i Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të shpërblimit të dëmit në emër të dhimbjeve shpirtërore për secilin paditës, ka pasur parasysh rrethanat e lidhjes familjare ashtu që për dhimbje shpirtërore ka caktuar shpërblimin si në pikën **I** të dispozitivit të aktgjykimit duke u bazuar në ekspertizën e psikiatrisë, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të elaboruara në ekspertizë për secilin paditës. Gjykata e shkallës së parë këtë shpërblim sa i përket lartësisë e ka marrë duke zbatuar dispozitën e nenit 184 të LMD-së, me të cilën është përcaktuar: *“Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t'u gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushte (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit) kompensim të drejtë në të holla për dhimbjet e tyre shpirtërore”*, *“Ky kompensim mund t'u gjykohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se midis tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme”*.

Gjykata e refuzoi kërkesëpadinë mbi shumat e gjykuara sa i përket dëmit jo material pasi që vlerësoi se në bazë të provave të administruara është vërtetuar se aksidenti është shkakuar edhe me kontributin sekondar të ndjerit- tani paditësit, andaj kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni dëmin e shkakuar dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejtë si dhe lartësia e kërkesës për këtë lloj të dëmit është e lartë dhe në kundërshtim me provat e administruara.

Gjykata, paditësve ia njohu edhe shpenzimet për ceremoninë e varrimit dhe të ngritjes së përmendores në shumë prej 1000.00€ për të ndjerin B.S, ashtu që mbi këtë shumë ia refuzoi këtë kërkesë për shkak të ndarjes së përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë për kompensimin e dëmit, gjykata e shkallës së parë me kërkesën e paditësve dhe në bazë të nenit 382 par.2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroi të paditurën që paditësve në shumat e gjykuara si në pikën **I** dhe **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ia paguaj edhe kamatën në lartësinë 8%, duke filluar nga data e marrjen së aktgjykimit.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës është mbështetur në dispozitën e nenit 449 e 459 par 2 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në

përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuara në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti me fatalitet, ka ndodhur me datë 18.012.2017, rreth orës 16:50 minuta, në aksin rrugor Gj.....-P....., përkatësisht në udhëkryqin në hyrje të fsh.....Pjesëmarrës në këtë aksident ishte automjeti i markës “Renault Kango”, me targë 01....., ngjyrë e kuqe, të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte Ç.G., në atë mënyrë që me të arritur në sakteshit në afërsi të udhëkryqit që shpie në fsh....., shoferi i të paditurës së parë duke mos i kushtuar kujdes këmbësorit i cili ka qenë në skaj të rrugës, në anën e djathtë, duke kaluar rrugën nga anan e djathtë në të majtë, shikuar në drejtim të lëvizjes së automjetit, me të vërejtur këmbësorin, edhe pse mundohet ti ikë goditjes, me automjet mundohet të kalojë në shiritin e kahjes së kundërt, në pamundësi ti ikë goditjes, në pjesën anësore të djathtë të automjetit e ka goditur këmbësorin në mes të shiritit të djathtë, e nga goditja këmbësori është përplasur në rrugë, në shiritin e djathtë dhe ka mbetur i shtrirë. Pastaj, shoferi B- NN i pa identifikuar me mjetin e tij ka qenë mbrapa mjetit A, e ka goditur këmbësori duke e tërhequr zvarr në rrugë. Si pasojë e këtij aksidenti, lëndime vdekjeprurëse ka pësuar këmbësori tani i ndjerë, B.S. Automjetet me të cilat është shkaktuar aksidenti kanë qenë të siguruara te këtu të paditura e parë, shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi primare në shkaktimin e këtij aksidenti është drejtuesi i automjetit Renault Kango me targa të regjistrimit 01.....të cilin e drejtonte Ç.G. i siguar te e paditura KS “SIGURIA”, ndërsa përgjegjësi sekondare në shkaktimin e këtij aksidenti ka drejtuesi i automjetit B i pa identifikuar e po ashtu përgjegjësi sekondare në këtë rast ka pasur edhe i ndjeri B.S, krejt kjo vërtetohet nga superkespertia e komunikacionit e datës 20.04.2021. Gjykata super ekspertizën e komunikacionit e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë prandaj të njëjtë e ka pranuar në tërësi si të besueshme. Mbi bazën e të lartcekurave gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë sipas kontributit të pjesëmarrësve në aksident dhe ka vendosur që përgjegjësia të jetë 60 % për të paditurën e parë Kompania e Sigurimeve “Siguria”, 30 % për të paditurën e dytë Byroja Kosovare të Sigurimeve, dhe 10 % për tani të njërin këmbësorin B.S.

Përgjegjësia për 60%, e të paditurës së parë KS “SIGURIA” konsiston në faktin se i siguar i saj drejtuesi automjeti A sepse në pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti ka qenë i pakujdesshëm duke mos e vërejtur me kohë daljen e këmbësorit në rrugë dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ndaj kushteve ekzistuese në rrugë dhe nuk ka arritur të shmangë aksidentin me këmbësorin duke e goditur atë, ndërsa përgjegjësia për 30%, e të paditurës së dytë Byroja Kosovare e Sigurimeve konsiston në faktin se automjeti “NN”, ngasësi i saj në pjesën e rrugës ku ka ndodhur aksidenti ka qenë i pakujdesshëm duke mos e vërejtur këmbësorin e shtrirë në rrugë dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ndaj kushteve ekzistuese në rrugë kështu që nuk ka arritur të shmangë aksidentin me këmbësorin duke e shkelur dhe tërhequr zvarrë në rrugë. Sa i përket përgjegjësies prej 10% te tani te ndjerit konsiston në faktin se i njëjti gjat trupimit të rrugës nuk është siguruara se ka automjete duke lëvizur në rrugë prandaj këmbësori është dashur të merr parasysh kushtet e zvogëluara të dukshmërisë ku objektet vërehen më pak dhe të jete me i kujdeshem gjat daljes në rrugë.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë drjek a vertuar faktin se paditësit janë familjarë gjegjësist janë femijet, e tani të ndjerit dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë, drejt ka vërtetuar

gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor.Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe propozohen prova të reja përveç se kur ankuesi i jep prova se pa fajin e vetë nuk mund ti paraqes përkatësisht ti propozoj gjerë në shqyrtimin kryesor në gjykatën e shkallës së parë ”. Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura e parë për 50% dhe e paditura e dytë të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësve për 30 % të përgjegjësisë, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi nga data 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të gjitha palëve - gjegjësisht të autorizuarve të tyre, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për kategoritë e dëmit jomaterial pasi që vlerësoj se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarit. Në këtë rast gjykata ka pasur parasysh raportin e paditësve me tani të ndjerin duke marr për bazë rrethanën se raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve si vëllezërve janë shumë emocionale, të ndjeshme dhe shpirtërore, dhe në këtë vështrim Gjykata e Apelit, vlerëson se dhimbjet shpirtërore të paditësve për shkak të vdekjes së djalit të tyre dhe vëllait, në fatkeqësi kanë qenë të larta, e duke marr parasysh edhe rrethanat familjare në Kosovë, veçanërisht rrethanën se si ka ndodhur fatkeqësia, për arsye se raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve dhe vëllezërve janë shumë emocionale dhe humbja e djalit/vëllait të tyre si dhe rrethanave se si ka ndodhur fatkeqësia, është manifestuar me dhimbje shpirtërore shumë të larta, dhe se këto dhembje nuk ka nevojë të vërtetohen me ekspertizë mjekësore sepse këto kanë qenë evidente tek paditësit, prandaj shumat e gjykuara për këtë aspekt të dëmit, nga ana e gjykatës është konsideruar se janë në pajtim me të mirën e shkelur dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi dhe se shumat e aprovuara për paditësit paraqesin një satisfaksion për ta. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket kësaj kategorie të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni me provat e administruara dhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë si dhe praktikën gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plot me nenin 184 paragraf 1 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë, për kompensimin e dëmit material, për shpenzimet e varrimit dhe ngritjen e përmendores, për arsye se me nenin 177 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit

të tij “, në këtë rast paditësve ju takon e drejta në kompensimin e këtij lloji të dëmit material. Në këtë rast palës paditëse si pasojë e aksidentit ju kanë shkaktuar shpenzime për varrim dhe ngritjes së permendores, e cila është vërtetuar me provat – fatura në shkresat e lëndës, Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë rast paditësve ju takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve për këto kategori të dëmeve ju njohin të drejtën në kompensim, e të cilat shuma janë në nivelin e shpenzimeve mesatare që u krijohen familjeve me rastin e këtyre ceremonive.

Lidhur me pikën III, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial mbi shumat e gjykuara, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak se në këtë rast shumat e kërkuara nga paditësit kanë qenë të larta dhe se shuma e kompensimit përtej shumës së gjykuar nuk do ti shërbente qëllimit të kompensimit të dëmit. Po ashtu edhe sa i përket kompensimit të dëmit material për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së permendores, përtej shumës së gjykuar është vërtetuar se pala paditëse nuk ka ofruar prova të mjaftueshme që vërtetojnë këto kategori të dëmit material.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, llogaritja e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 07.05.2019, e deri në pagesën definitive, sepse paditësit për dëmin dhe lartësinë e tij, kanë rënë në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tyre për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se të paditurat kanë rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit. Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon vendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket lartësisë së kamatës, ndërsa kërkesës së të autorizuarit të paditësve lidhur me normën e kamatës prej 12 %, nuk mund të zbatohet në këtë rast sepse në rastin konkret kërkesa për dëmshpërblim e datës 06.11.2013 është e shënuar vetëm me dorë dhe se njëjta nuk përmban ndonjë datë apo vulë se kur është pranuar në kompani të sigurimit dhe se në cilën kompani të sigurimit është dorëzuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.10781/2021, me datë 11.06.2024

Kryetari i kolegjit  
N. Mehulli, d.v